


*Tremujori i katërt 2012*

# INDEKSI i ÇMIMEVE të PRODHIMIT



## PËRDORUES

### **Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) mat ndryshimin e çmimeve të produkteve në pikën e parë të shitjes pas prodhimit.**

Indeksi mbulon aktivitetet ekonomike të mëposhtëme:

- Industri nxjerrëse, C: 10-14
- Industri përpunuese, D: 15-36
- Energji elektrike, ujë dhe gaz, E : 40-41

Ky indeks nuk përfshin degët e peshkimit dhe silvikulturës. Sipas metodologjisë së EUROSTATI-it indeksi i prodhimit për këto dy degë duhet llogaritur veçmas dhe emërtohet Indeksi i Prodhimit për Bujqësinë. Llogaritja e këtij indeksi është objektiv i mëvonshëm i Sektorit të Çmimeve.

INSTAT llogarit Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas dhe Indeksin e Çmimeve të Eksportit , kështu indeksi llogaritet dhe publikohet si:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas
- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për Eksport

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror.

Për rinovimin e shportës së ndërmarrjeve dhe shportës së produkteve u shfrytëzuan rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike të vitit 2004.

Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas u realizua duke u mbështetur në rezultatet e po kësaj ankete ndërsa pesha e produkteve me destinacion eksport u realizua duke shfrytëzuar të dhënat statistikore të tregtisë së jashtme.

Në Indeksin e Çmimeve të Prodhimit peshat e produkteve do të rinovohen çdo vit duke eliminuar në këtë mënyrë imputimet e çmimeve për produktet që mund të mos prodhohen në vitet në vazhdim.

## INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMIT TREMUIJORI I KATËRT 2012

Në tremujorin e katërt të vitit 2012, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 113.1 përqind (Viti 2005 = 100), duke shënuar një rritje prej 0.3 përqind kundrejt tremujorit të tretë 2012.

Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është +0.1 përqind.

Industria Nxjerrëse shënoi një rritje prej 0.5 përqind. Këtu mund të përmendim rritjen e çmimeve të produkteve në aktivitetin "Nxjerrja e produkteve energjitike" me 2.6 përqind.


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në degën "Industri Përpunuese" shënoi rritje me 0.4 përqind. Brënda saj mund të përmendim rritjen e çmimeve të prodhimit të produkteve në aktivitetet: "Industria tekstile" me 2.4 përqind, "Fabrikimi i mobiljeve" me 2.4 përqind, "Industria ushqimore" me 0.1 përqind.

Ulje të çmimeve kanë pësuar kryesisht aktivitetet: " Rafinimi i naftës; koksifikimi" me 0.1 përqind, "Industria kimike" me 2.5 përqind.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për produktet vendase arriti 111.2 përqind duke shënuar një rritje prej 0.1 përqind krahasuar me tremujorin e tretë 2012. Këtu mund të përmendim rritjen e çmimeve në degët: "Industria nxjerrëse" me 2.0 përqind dhe "Industria përpunuese" me 0.1 përqind.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit (viti 2005 = 100) arriti 120.3 përqind duke shënuar një rritje prej 0.8 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Këtu mund të përmendim rritjen e çmimeve të produkteve në degën "Industria përpunuese" me 1.1 përqind.

**Indeksi i Çmimeve të Prodhimit**



**Indeksi i Çmimeve të Prodhimit  
( Me bazë aktivitetin ekonomik )**

2005 = 100

NVE	Përshkrimi	Peshat %	10- 12	11- 12	12- 12	IV -12
<b>Gjithsej</b>		<b>100.0</b>	<b>113.1</b>	<b>113.1</b>	<b>113.1</b>	<b>113.1</b>
<b>C</b>	Industria nxjerrëse	7.7	139.5	139.2	139.3	139.3
CA	Nxjerrja e produkteve energjitike	2.5	183.5	183.5	183.5	183.5
10	Nxjerrja e qymyrgurit, të linjiteve dhe të shtresave të varfra të mineralit	0.1	103.6	103.6	103.6	103.6
11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyral, shërb.plotës. në nx.e naftës dhe të gazit, përveç studi. gjeolo.	2.4	183.8	183.8	183.8	183.8
CB	Nxjerrja e produkteve jo energjitike	5.2	99.0	98.8	98.8	98.9
13	Nxjerrja e mineraleve metalike	3.7	99.8	99.3	99.4	99.5
14	Industri të tjera nxjerrëse	1.5	96.3	96.5	96.5	96.4
<b>D</b>	Industria përpunuese	70.7	123.5	123.6	123.6	123.6
DA	Industria ushqimore	9.0	129.4	128.4	128.8	128.9
15	Industria e produkteve ushqimore dhe pijeve	8.8	130.4	129.4	129.8	129.8
16	Industria e duhanit	0.2	78.4	78.4	78.4	78.4
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	2.4	125.7	125.7	125.7	125.7
17	Industria tekstile	0.3	124.6	124.3	124.2	124.4
18	Industria e veshjes dhe gëzofëve	2.1	124.9	124.8	124.9	124.9
DC	19 Përg.tanini i lëkurës, fab.i artik. të udhëtimit dhe galanterisë, fab.i pajimeve të kuajve dhe fab.i këpuc.	2.0	132.4	132.8	132.3	132.5
DD	20 Prodh. i drurit dhe i artik. me dru e me dushk përveç prodh. të mobiljeve	0.7	116.2	115.9	116.7	116.3
DE	Industria e letrës, kartonit, botime	1.1	110.7	110.7	110.7	110.7
21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe i artikujve prej letre dhe prej kartoni	0.6	103.9	103.9	103.9	103.9
22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	0.5	116.1	116.1	116.1	116.1
DF	23 Rafinimi i naftës; koksifikimi; industria bërthamore	32.5	186.5	186.5	186.5	186.5
DG	24 Industria kimike	2.1	89.9	90.1	90.0	90.0
DH	25 Industria e kauçukut dhe e plastikës	1.5	111.1	116.3	115.4	114.3
DI	26 Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalike	6.7	93.7	93.7	93.6	93.7
DJ	27 Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	9.7	118.5	118.8	118.9	118.7
28	Siderurgjia	7.0	117.5	117.9	118.1	117.8
28	Punime me metal	2.7	120.8	120.8	120.8	120.8
DK	29 Fabrikimi i makinave dhe paisjeve	0.5	138.6	138.6	138.6	138.6
DL	Fabrikimi i paisjeve elektrike e elektronike	0.4	120.8	120.9	120.9	120.9
31	Fabrikimi i makinave dhe i aparateve elektrike	0.1	126.9	127.0	127.0	126.9
32	Fabrikimi i paisjeve dhe aparateve të radios, televizionit dhe të komunikacionit	0.2	104.3	104.3	104.3	104.3
33	Fabrikimi i instrumentave mjekësorë, precizionit, optike	0.1	93.4	93.4	93.4	93.4
DM	Fabrikimi i mjeteve të transportit	0.1	100.0	100.0	100.0	100.0
34	Konstruktimi i mjeteve të transp.,automobilave, rimorkjove dhe të gjysëm rimorkjove	0.1	100.0	100.0	100.0	100.0
DN	Fabrikimi i mobiljeve dhe shërbime të tjera	2.3	129.3	129.3	129.3	129.3
36	Fabrikimi i mobiljeve, industri të ndryshme	1.4	133.5	133.5	133.5	133.5
37	Shërbime të rikuperimit të materialeve metalike rrafshuese	0.9	98.1	98.1	98.1	98.1
<b>E</b>	<b>EE</b> Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	21.5	77.3	77.3	77.3	77.3
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit të ngrohtë	20.4	72.1	72.1	72.1	72.1
41	Depozitimi, trajtimi dhe shpërndarja e ujit	1.1	119.6	119.6	119.6	119.6

**Ndryshimet në përqindje të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit  
( Me bazë aktivitetin ekonomik )**

2005 = 100

NVE	Përshkrimi	Peshat %	Ndryshimet në përqindje	
			IV -12*	IV - 12**
			III - 12	IV- 11**
<b>Gjithsej</b>		<b>100.0</b>	<b>0.3</b>	<b>0.1</b>
<b>C</b>	Industria nxjerrëse	7.7	0.5	0.6
CA	Nxjerrja e produkteve energjitike	2.5	2.6	4.0
10	Nxjerrja e qymyrgurit, të linjiteve dhe shtresave të varfra të mineralit	0.1	0.0	0.0
11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyral, shërb.plotës. në nx.e naftës dhe të gazit, përveç studi. gjeolo.	2.4	2.6	4.0
CB	Nxjerrja e produkteve jo energjitike	5.2	-0.5	-1.0
13	Nxjerrja e mineraleve metalike	3.7	-0.6	-0.6
14	Industri të tjera nxjerrëse	1.5	-0.4	-0.1
<b>D</b>	Industria përpunuese	70.7	0.4	-0.1
DA	Industria ushqimore	9.0	0.1	1.7
15	Industria e produkteve ushqimore dhe pijeve	8.8	0.1	1.7
16	Industria e duhanit	0.2	0.0	0.2
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	2.4	1.1	1.5
17	Industria tekstile	0.3	2.4	1.6
18	Industria e veshjes dhe gëzofëve	2.1	0.9	1.5
DC	19 Përg.tanini i lëkurës, fab.i artik. të udhëtimit dhe galanterisë, fab.i pajimeve të kuajve dhe fab.i këpuc.	2.0	2.4	4.8
DD	20 Prodh. i drurit dhe i artik. me dru e me dushk përveç prodh. të mobiljeve	0.7	0.5	0.4
DE	Industria e letrës, kartonit, botime	1.1	-2.4	-1.0
21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe i artikujve prej letrë dhe prej kartoni	0.6	0.4	1.7
22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	0.5	-5.5	-4.2
DF	23 Rafinimi i naftës; koksifikimi; industria bërthamore	32.5	-0.1	-1.5
DG	24 Industria kimike	2.1	-2.5	-2.1
DH	25 Industria e kauçukut dhe e plastikës	1.5	0.3	3.1
DI	26 Fabrikimi i artikujve të tjerë minerale jo metalike	6.7	0.3	-0.2
DJ	27 Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	9.7	1.9	1.1
28	Siderurgjia	7.0	2.7	1.3
28	Punime me metal	2.7	-0.1	0.7
DK	29 Fabrikimi i makinave dhe paisjeve	0.5	0.8	1.8
DL	Fabrikimi i paisjeve elektrike e elektronike	0.4	1.9	2.1
31	Fabrikimi i makinave dhe i aparateve elektrike	0.1	4.5	3.0
32	Fabrikimi i paisjeve dhe aparateve të radios, televizionit dhe të	0.2	2.3	
33	Fabrikimi i instrumentave mjekësorë, precizionit, optike	0.1	0.0	-1.9
DM	Fabrikimi i mjeteve të transportit	0.1	0.0	
34	Konstruktimi i mjeteve të transp.,automobilave, rimorkjove dhe të gjysm rimorkjove	0.1	0.0	
DN	Fabrikimi i mobiljeve dhe shërbime të tjera	2.3	2.4	4.1
36	Fabrikimi i mobiljeve, industri të ndryshme	1.4	3.8	4.5
37	Shërbime të rikuperimit të materialeve metalike riaftësuese	0.9	0.4	3.3
<b>E</b>	<b>EE</b> Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	21.5	0.0	0.4
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit të ngrohtë	20.4	0.0	0.3
41	Depozitimi, trajtimi dhe shpërndarja e ujit	1.1	0.0	2.5

\* Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tre mujorit të mëparshëm

\*\* Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e tremujorit korrent me tremujorin e njëjtë të vitit të mëparshëm

**Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për produktet vendase  
( Me bazë aktivitetin ekonomik )**

2005 = 100

NVE	Përshkrimi	Peshat %	10- 12	11- 12	12- 12	IV-12	IV - 12 / III - 12
<b>Gjithsej</b>		<b>100.0</b>	<b>111.2</b>	<b>111.2</b>	<b>111.1</b>	<b>111.2</b>	<b>0.1</b>
<b>C</b>	Industria nxjerrëse	4.4	147.3	147.4	147.4	147.3	2.0
CA	Nxjerrja e produkteve energjitike	2.0	202.8	202.8	202.8	202.8	4.5
10	Nxjerrja e qymyrgurit, të linjiteve dhe të shtresave të varfra të mineralit	0.1	138.0	138.0	138.0	138.0	0.0
11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyral, shërb.plotës. në nx.e naftës dhe të gazit, përveç studi. gjeolo.	1.9	203.1	203.1	203.1	203.1	4.5
CB	Nxjerrja e produkteve jo energjitike	2.4	101.0	101.2	101.2	101.1	-0.1
13	Nxjerrja e mineraleve metalike	0.9	114.0	114.0	114.0	114.0	0.0
14	Industri të tjera nxjerrëse	1.5	94.5	94.8	94.8	94.7	-0.2
<b>D</b>	Industria përpunuese	67.0	122.9	122.8	122.8	122.8	0.1
DA	Industria ushqimore	7.7	134.0	133.8	133.6	133.8	1.2
15	Industria e produkteve ushqimore dhe pijeve	7.5	134.8	134.7	134.4	134.6	1.2
16	Industria e duhanit	0.2	91.3	91.3	91.3	91.3	0.0
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	0.9	120.9	121.0	121.0	121.0	1.6
17	Industria tekstile	0.1	124.3	124.6	124.4	124.4	3.9
18	Industria e veshjes dhe gëzofëve	0.8	119.7	119.7	119.7	119.7	1.4
DC	19 Përg.tanini i lëkurës, fab.i artik. të udhëtimit dhe galanterisë, fab.i pajimeve të kuajve dhe fab.i këpuc.	0.8	137.1	136.7	136.8	136.9	6.9
DD	20 Prodh. i drurit dhe i artik. me dru e me dushk përveç prodh. të mobiljeve	0.2	103.1	103.4	104.1	103.5	-2.9
DE	Industria e letrës, kartonit, botime	0.6	118.9	118.9	118.9	118.9	-0.4
21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe i artikujve prej letrë dhe prej kartoni	0.3	115.6	115.6	115.6	115.6	-0.3
22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suportëve të	0.3	124.6	124.6	124.6	124.6	-0.5
DF	23 Rafinimi i naftës; koksifikimi; industria bërthamore	43.2	186.5	186.5	186.5	186.5	-0.1
DG	24 Industria kimike	2.3	87.9	88.0	87.8	87.9	-2.6
DH	25 Industria e kauçukut dhe e plastikës	1.4	113.5	113.5	113.5	113.5	-0.2
DI	26 Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalike	5.7	92.1	92.0	91.8	92.0	-0.4
DJ	Metallurgjia dhe përpunimi i metaleve	2.9	113.5	113.5	113.5	113.5	0.0
27	Siderurgjia	2.8	112.9	112.8	112.8	112.9	0.0
28	Punime me metal	0.1	112.8	112.9	112.8	112.8	0.2
DK	29 Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve	0.1	129.0	129.0	129.0	129.0	-1.0
DL	31 Fabrikimi i makinave dhe i aparateve elektrike	0.1	103.4	103.7	103.6	103.6	8.3
DM	Fabrikimi i mjeteve të transportit	0.1	100.0	100.0	100.0	100.0	0.0
34	Konstruktimi i mjeteve të	0.1	100.0	100.0	100.0	100.0	0.0
DN	Fabrikimi i mobiljeve dhe shërbime të tjera	1.0	115.0	115.0	114.5	114.8	1.3
36	Fabrikimi i mobiljeve, industri të ndryshme	0.4	126.4	126.5	124.9	126.0	3.3
37	Shërbime të rikuperimit të materialeve metalike	0.6	94.9	94.9	94.9	94.9	0.0
<b>E</b>	EE Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e avullit dhe e ujit të ngrohtë	28.6	77.3	77.3	77.3	77.3	0.0
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit të ngrohtë	27.1	72.1	72.1	72.1	72.1	0.0
41	Depozitimi, trajtimi dhe shpërndarja e ujit	1.5	119.6	119.6	119.6	119.6	0.0

**Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për Eksport  
( Me bazë aktivitetin ekonomik )**

2005 = 100

NVE	Përshkrimi	Peshat %	10- 12	11- 12	12- 12	IV -12	IV - 12 / III - 12
<b>Gjithsej</b>		<b>100.0</b>	<b>120.1</b>	<b>120.2</b>	<b>120.4</b>	<b>120.3</b>	<b>0.8</b>
C	Industria nxjerrëse	18.0	112.8	112.4	112.4	112.5	-0.6
CA	Nxjerrja e produkteve energjitike	4.5	100.0	100.0	100.0	100.0	0.0
10	Nxjerrja e qymyrgurit, të linjiteve dhe të shtresave të varfra të mineralit						
11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyral, shërb.plotës. në nx.e naftës dhe të gazit, përveç studi. gjeolo.	4.5	100.0	100.0	100.0	100.0	0.0
CB	Nxjerrja e produkteve jo energjitike	13.5	99.9	99.3	99.4	99.5	-0.7
13	Nxjerrja e mineraleve metalike	12.3	92.9	92.4	92.5	92.6	-0.7
14	Industri të tjera nxjerrëse	1.2	105.7	105.7	105.7	105.7	-1.0
D	Industria përpunuese	82.1	127.3	127.6	127.8	127.5	1.1
DA	Industria ushqimore	13.2	121.1	118.9	120.3	120.1	-1.7
15	Industria e produkteve ushqimore dhe pijeve	13.1	121.4	119.2	120.7	120.4	-1.8
16	Industria e duhanit	0.1	85.5	85.5	85.5	85.5	0.0
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	6.8	125.7	125.6	125.7	125.7	0.9
17	Industria tekstile	0.8	124.6	124.1	124.1	124.3	2.0
18	Industria e veshjes dhe gëzofëve	6.0	124.8	124.8	124.8	124.8	0.7
DC	19 Përg.tanini i lëkurës, fab.i artik. të udhëtimit dhe galanterisë, fab.i pajimeve të kuajve dhe fab.i këpuc.	5.7	131.3	131.9	131.2	131.5	0.7
DD	20 Prodh. i drurit dhe i artik. me dru e me dushk përveç prodh. të mobiljeve	2.1	120.8	120.4	121.2	120.8	1.7
DE	Industria e letrës, kartonit, botime	2.5	97.7	97.7	97.7	97.7	-3.7
21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe i artikujve prej letre dhe prej kartoni	1.3	98.2	98.2	98.2	98.2	0.8
22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të	1.2	91.0	91.0	91.0	91.0	-9.0
DG	24 Industria kimike	1.2	98.9	99.6	99.6	99.4	-1.9
DH	25 Industria e kauçikut dhe e plastikës	1.8	113.2	131.6	128.4	124.4	1.5
DI	26 Fabrikimi i artikujve të tjerë minerale jo metalike	9.6	112.6	112.6	112.6	112.6	1.6
DJ	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	30.0	121.3	121.7	121.9	121.6	2.4
27	Siderurgjia	19.2	119.9	120.6	120.8	120.5	3.9
28	Punime me metal	10.8	120.9	120.9	120.9	120.9	-0.1
DK	29 Fabrikimi i makinave dhe paisjeve	1.8	144.6	144.6	144.6	144.6	0.9
DL		1.1	120.5	120.5	120.5	120.5	1.5
31	Fabrikimi i makinave dhe i aparateve elektrike	0.1	123.9	123.9	123.9	123.9	2.1
32	Fabrikimi i paisjeve dhe aparateve të radios, televizionit	0.6	104.3	104.3	104.3	104.3	2.3
33	Fabrikimi i instrumentave mjekësorë, precizionit, optike	0.4	93.4	93.4	93.4	93.4	0.0
DN		6.2	147.2	147.3	147.6	147.4	2.9
36	Fabrikimi i mobiljeve, industri të ndryshme	4.4	145.8	145.8	146.3	146.0	3.9
37	Sherbime të rikuperimit të materialeve metalike rrafshesuese	1.8	106.6	106.6	106.6	106.6	0.7

## Metodika e llogaritjes të Indeksit

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit është indeks me periudhë bazë vitin 2005 (2005= 100). Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir sipas së cilës çmimet e periudhës korente do të krahasohen me çmimet e periudhës bazë në menyrë zinxhir, duke patur si periudhë lidhëse muajin Dhjetor të vitit të mëparshëm.

Çmimet relative llogariten si raport i çmimit të produktit në periudhën korente (y) me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y - 1). Çmimet relative peshohen së bashku për të dhënë indeksin në nivel 6-shifror për çdo grup produkti. Indekset e llogaritura në nivel 6-shifror agregohen së bashku për të dhënë indeksin në nivel 2 shifror dhe kështu me rradhë deri në llogaritjen përfundimtare të Indeksit total të Çmimeve të Prodhimit.

E njëjta metodologji përdoret dhe për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Eksportit dhe Indeksit të Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas.

Për vitin 2005 dhe 2006 Indekset e Çmimeve për Eksportin dhe produktet për tregun vendas mungojnë. Për llogaritjen e tyre si indekse zinxhir janë përdorur të njëjtët indekse që janë përdorur për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit.

### Çmimi relativ

Çmimi relativ është raporti i çmimit të produktit në periudhën korente me çmimin e produktit në dhjetor të vitit të mëparshëm.

### Peshimi

Për llogaritjen e indekseve të produkteve në nivel 6-shifror është përdorur mesatarja e peshuar aritmetike e indekseve elementare. Indeksi në (short - term - link) për nivelin 6-shifror është llogaritur duke shumëzuar çmimin relativ të çdo produkti në nivel 6- shifror me peshën koresponduese dhe duke pjesëtuar shumën e tyre me shumën e peshave

### Imputimi

Imputimet e çmimeve që mungojnë është bërë duke shumëzuar çmimin e periudhës së mëparshme me ndryshimin mesatar të çmimeve të produkteve të grupit në të cilin bën pjesë produkti ( në nivelin më të ulët të agregimit 6 ose 2 shifror).

### Llogaritja e indeksit

Për llogaritjen e indeksit është përdorur formula e tipit Laspeyres i cili llogaritet sipas formulas:

$$L(1) \quad I_0^t = \frac{\sum_i P_{t,i} Q_{0,i}}{\sum_i P_{0,i} Q_{0,i}} = \sum_i \frac{P_{0,i} Q_{0,i}}{\sum_i P_{0,i} Q_{0,i}} \times \frac{P_{t,i}}{P_{0,i}}$$

ku:

I (t) – indeksi i periudhës t krahasuar me bazën 0 ;

P<sub>t</sub>i – çmimi i artikullit i në periudhën t;

P<sub>0</sub>i – çmimi i artikullit i në periudhën 0 ;

Q<sub>0</sub>i – sasia e artikullit i në periudhën 0.

### Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet nga efektet e papërsëritshme të cilitdo tremjor.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit midis dy tremujorëve më të fundit. Megjithëse korent, ai mund të ndikohet nga efekte sezonale dhe efekte të tjera.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Blv. "Zhan D'Ark" Nr.3, Tiranë, Tel: + 355 4 2222411/2233356, Fax: + 355 4 2228300,  
email: botim\_difuzion@instat.gov.al web: www.instat.gov.al